



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.2/2020

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bahrije Smakolli, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurës M. S. nga Vushtrria rr. “...” për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.3663/19 e datës 03.01.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor jo - publik të datës 20.07.2020, në praninë e Prokurorit të shtetit Shpëtim Peci, të pandehurës M. S., të dëmtuarës M. Rr., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 20.07.2020, me datë **27.07.2020** përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

E PANDEHURA: M. S. me pseudonimin I. nga i ati H., e ëma M., e gjinisë P. e lindur me datë ..., me numër personal ,,,,, me vendbanim në Vushtrri, rr. “...”, e pa martuar – nënë e dy fëmijëve, e gjendjes së dobët ekonomike, më parë e pa gjykuar shqiptare, shtetase i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE: Ekziston dyshimi i bazuar i mirë se e pandehura me datë 21.10.2019, rreth orës 17:20 në rrugën në sheshin e qyteti në Vushtrri, saktësisht në bulevardin “...”, me dashje pas një mosmarrëveshjeje të mëhershme me të dëmtuarën, të njëjtën e sulmon fizikisht fillimisht duke e kapur për krahu, kurse më pastaj të njëjtën e godet me shqelm në këmbë, e si rezultat i sulmit të dëmtuarës – dëshmitares M. Rr. në bazë të ekspertizës mjeko - ligjore i shkakton ndrydhje në bërrylin e djathtë dhe në shputën e djathtë, dëmtime këto të lehta trupore, me pasoja të përkohshme shëndetësore.

- **Me këtë ka kryer veprën penale – Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, dhe nenit 185 të KPRK-së si dhe nenit 365, 450 dhe 46r të KPPK-së, e

G J Y K O N

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej njëmijë euro (1000 €), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se e pandehura refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 € (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

E dëmtuara M. Rr. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullte civil.

DETYROHET e pandehura që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30 €).

DETYROHET e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30 €).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur PP.II.nr.3663/19 e datës 03.01.2020 kundër të pandehurës M. S. nga Vushtrria rr. “...” për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së

Gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të propozimit të Prokurorisë ka nxjerrë Aktgjykim – Urdhër Ndëshkimor me datë 12.02.2020, ndaj të cilit Urdhër e pandehura me datë 28.02.2020 ka paraqitur kundërshtim.

Gjykata me datë 14.07.2019 ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në këtë seancë e pandehura nuk e ka pranuar fajësinë. Gjykata me datë 20.07.2020 ka vazhduar seancën e shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë çështje penale dhe pas administrimit të provave dhe shqyrtimit gjyqësor ka shpallur aktgjykimin në praninë e palëve.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor në fjalën hyrëse ka deklaruar se, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor pas administrimit të provave do të vërtetohet gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë, dhe atë në bazë të dëshmisë së të dëmtuarës M. Rr. e cila është propozuar në cilësinë e dëshmitares, e cila do të na tregojë se si e pandehura ditën kritike e ka sulmuar dhe në cilat pjesë i ka shkaktuar lëndime, po ashtu dëshmitari B. S. do të na tregojë për mosmarrëveshjet e mëhershme që mund të kenë quar deri te sulmi fizik nga e pandehura, po ashtu edhe vetë e pandehura do na tregojë rrjedhjen e ngjarjes e cila gjatë fazës së hetimeve e ka pranuar se e ka kapur për krahit të dëmtuarën në ditën kritike, koj do të vërtetohet edhe nga provat materiale konkretisht ekspertiza mjeko ligjore ku vërtetohen lëndimet si dhe foto – dokumentacioni, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në bazë të dëshmimeve të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë, dhe atë në bazë të dëshmisë së të dëmtuarës – dëshmitares M. Rr., ku në dëshminë e saj ka përshkruar ngjarjen kritike dhe se si është sulmuar dhe nga provat materiale raportet mjekësore të cilat përshkruajnë natyrën e lëndimit. Po ashtu në dëshminë e dhënë B. S. i cili ka treguar se në çfarë gjendje e ka takuar të dëmtuarën dhe njëherit përshkrimin e lëndimeve që i ka pa tek e dëmtuara.

Andaj në bazë të këtyre fakteve i ka propozuar gjykatës që të pandehurën ta shpall fajtores dhe ta dënoj sipas ligjit për veprat penale të cekuar, si dhe i ka propozuar gjykatës të merrë parasysh si rrethanë lehtësuese dhe rënduese të kësaj çështje penale.

E dëmtuara në fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në tërësi e mbështet prokurorin e shtetit dhe njëherit ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material lidhur me këtë çështje penale.

E pandehura në fjalën hyrëse të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e ndjenë vetën të pafajshme për faktin se e dëmtuara ja ka shqetësuar familjen dy ditë para mosmarrëveshjes duke ju shkuar në shtëpi, më pas se si e njëjta e ka ndalur të dëmtuarën në rrugë si mike për ti thënë dhe duke e prekur në krah duke i sqaruar se e dëmtuara ja ka shqetësuar familjen dhe se si burri i të dëmtuarës F. në prezencë të të dëmtuarës ka kërkuar që ajo të jetë gruaja e saj, ndërsa fjalën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk e ka lënduar askënd dhe të gjitha problemet me të dëmtuarën rrjedhin si rezultat i mosmarrëveshjeve me burrin e të dëmtuarës, i cili është edhe prind i dy fëmijëve të saj.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional, dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të pandehurës si dhe faktet në favor të saj, duke i mundësuar të pandehurës, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

Provat personale

- Dëgjimin e të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares – M.Rr. e cila në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.07.2020, ka deklaruar se ditën kritike të datë 21.10.2019 rreth orën 17:50 ka qenë me gruan e djalit të axhës duke ecur në Bulevardin “A.J.”, dhe e pandehura ishte e ulur para banesës me dy fëmijët e saj dhe me qëllim që të mos bie në kontakt me të kam hyrë në lokalin “...”, dhe më pas kur kanë dal, djali i madh i të pandehurës i ka treguar se po dalin dhe më pas e pandehura i ka dalë përpara e ka kapur për krahu në dorën e djathtë të muskulit të dorës dhe i ka thënë pse ke qenë të nëna ime, më pas e pandehura e ka mbajtur për krahu, e ka ofenduar dhe më pas pasi që e ka lëshuar nga krahu, e njëjta e ka goditur me shqelm në zogun e këmbës, dhe më pas se si vëllai i saj Bajram Smakolli e ka thirrë në telefon dhe më pas i ka treguar për ngjarjen, kanë shkuar në Stacionin Policor në Vushtrri me vëllain e saj dhe me bashkëshortin si dhe në emergjencë.

- Dëgjimin e dëshmitarit – B.S., i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.07.2020, ka deklaruar se ditën kritike të datë 21.10.2019 fillimisht e ka thirrë motrën – të dëmtuarën në telefon dhe nga zëri i saj e ka kuptuar se diçka nuk është në rregull, dhe më pas e ka takuar te Parku i qytetit me bashkëshortin e saj F. Rr. dhe se si të njëjtit e kanë njoftuar se po shkojnë në Stacionin policor, nuk i kujtohet saktësisht koha por ka qenë diku 10 minuta pasi që e ka thirrë e pandehura në telefon dhe e ka kërcënuar se do të shkojë me dy fëmijët e saj në familjen e saj, më

pas e dëmtuara e ka njoftuar për dëmtimet e pësuara në kraharorë dhe në këmbë në pjesën e zogut të këmbës nga mbrapa.

E pandehura në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.07.2020 ka deklaruar se, ditën kritike deri sa ka qenë me dy fëmijët e saj që sipas saj janë fëmijët që i ka me bashkëshortin e të dëmtuarës, me datë 21.10.2019 rreth orës 17:20 ka takuar të dëmtuarën – M. Rr. dhe e ka kapur për krahu dhe i ka kërkuar sqarime pse e njëjta ka shkuar në familjen e saj dhe e ka shqetësuar por nuk e ka dëmtuar. E pandehura gjatë marrjes në pyetje ka deklaruar se e dëmtuara ka kërkuar që unë të ja lëshojë dorën me arsyen se jemi në qytet dhe më pas ja kam lëshuar.

E pandehura gjatë marrjes në pyetje ka deklaruar se të dëmtuarën nuk e ka lënduar asnjëherë dhe se e ka kapur për krahu – dore në mënyrë shoqërore.

Provat materiale

- Raportin policor të Njësisë së hetimeve – Vushtrri të datës 21.10.2016 ku është përshkruar rasti se si është njoftuar policia për rastin nga e dëmtuara, se si ka ndodhur ngjarja, si i janë shkaktuar lëndimet të dëmtuarës, se si e pandehura në vazhdimësi sa herë ta takon e ofendon në qytet, më pas raporti përshkruan edhe marrjen në pyetje të dëshmitarit B.S. dhe të pandehurën M. S., si dhe se në Stacionin Policor në Vushtrri e dëmtuara dhe e dyshuara kanë raportuar raste edhe më herët për mosmarrëveshjet që kanë pasur në mes vete.

- Nga mesazhet e dërguar nga e pandehura në drejtim të dëmtuarës dhe anasjelltas shihet për mosmarrëveshjet paraprake që kanë ekzistuar në mes tyre dhe si rezultat i tyre ka ardhur deri lëndimet e pësuara nga e dëmtuara,

- Raportin mjekësor të datës 21.10.2019 të Qendrës Emergjente – Spitalit “Sheikh Zayed”, në Vushtrri është përshkruar se si pacientja është sjellë ne Qendrën Emergjente për shkak të dhunës fizike, dhe pas caktimit të diagnozës së të dëmtuarës e njëjta është udhëzuar ta konsultojë mjekun ligjor për caktuar shkallën e lëndimit,.

- Akt Ekspertimin Mjeko Ligjor të datës 14.12.2019 të përgatitur nga mjeku ligjor Dr. Musa Gashi, në të cilin është konstatuar natyra e lëndimeve të të dëmtuarës M. Rr. dhe atë, dëmtime të lehta trupore.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Faktet jokontestuese

- Është fakt jo kontestues se në ditën kritike të datës 21.10.2019, rreth orës 17:20 në rrugën në sheshin e qytetit në Vushtrri, saktësisht ne bulevardin “...”, e pandehura është takuar me të dëmtuarën, dhe e ka kapur për dore të dëmtuarën

Ky fakt nuk është kontestuar nga palët. Përveç kësaj faktet vërtetohen edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

Faktet kontestuese

- Është fakt kontestues se e pandehura e ka sulmuar dhe i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarës me datë rreth orës 17:20 në sheshin e qytetit në Vushtrri, saktësisht në bulevardin "...”,

Ky fakt është kontestuar nga ana e të pandehurës në fjalën hyrëse, gjatë shqyrtimit gjyqësor, në fjalën përfundimtare dhe me rastin e marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Vlerësimi i provave nga gjykata

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dsipozitiv të aktgjykimit. Këtë gjendje faktike, gjykata e vërtetoi në bazë të:

- deklaratës së të dëmtuarës - dëshmitares - M.Rr., e cila në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.07.2020, ka deklaruar se ditën kritike të datë 21.10.2019 rreth orën 17:50, e pandehura e ka mbajtur për krahu, e ka ofenduar dhe më pas pasi që e ka lëshuar nga krahu, e njëjta e ka goditur me shqelm në zogun e këmbës.

- Dëshmisë së dhënë nga dëshmitari B. S., i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.07.2020, ka deklaruar se ditën kritike të datë 21.10.2019 fillimisht e ka thirrë motrën – të dëmtuarën në telefon dhe nga zëri i saj e ka kuptuar se diçka nuk është në rregull, dhe më pas e ka takuar te Parku i qytetit me bashkëshortin e saj F. Rr. dhe se si të njëjtit e kanë njoftuar se po shkojnë në Stacionin policor, më pas e dëmtuara e ka njoftuar për dëmtimet e pësura në kraharorë dhe në këmbë në pjesën e zogut të këmbës nga mbrapa, të cilat dëmtime i ka vërejtur edhe vetë ai,

- Marrjes në pyetje e të pandehurës e cila në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 20.07.2020 ka deklaruar se ditën kritike deri sa ka qenë me dy fëmijët e saj, me datë 21.10.2019 rreth orës 17:20 ka takuar të dëmtuarën – M.Rr.i dhe e ka kapur për krahu dhe i ka kërkuar sqarime pse e njëjta ka shkuar në familjen e saj dhe e ka shqetësuar por nuk e ka dëmtuar. E pandehura gjatë marrjes në pyetje ka deklaruar se e dëmtuara ka kërkuar që unë të ja lëshojë dorën me arsyen se jemi në qytet dhe më pas ja kam lëshuar.

Gjykata i vlerësoi dhe ia fali besimin deklaratës së të dëmtuarës në cilësinë e dëshmitares dhe deklaratën e dëshmitarit, si deklarata bindëse, konsistente dhe reale, ndërsa pjesërisht e vlerësoi edhe deklaratën e dhënë nga vetë e pandehura gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor ka pranuar se ka kapur për dore të dëmtuarën

Gjykata i vlerësoi se deklaratat e dëshmitarëve janë, bindëse, konsistente dhe reale dhe në pajtim edhe me provat materiale, përfshirë:

- Raportin policor të Njësisë së hetimeve – Vushtrri të datës 21.10.2016 ku është përshkruar rasti se si është njoftuar policia për rastin nga e dëmtuara, se si ka ndodhur ngjarja, si i janë shkaktuar lëndimet të dëmtuarës, se si e pandehura në vazhdimësi sa herë ta takon e ofendon në qytet, si dhe se si në Stacionin Policor në Vushtrri e dëmtuara dhe e dyshuara kanë raportuar raste edhe më herët për mosmarrëveshjet që kanë pasur në mes vete.

- Nga mesazhet e dërguar nga e pandehura në drejtim të dëmtuarës dhe anasjelltas shihet për mosmarrëveshjet paraprake që kanë ekzistuar në mes tyre dhe si rezultat i tyre ka ardhur deri lëndimet e pësuar nga e dëmtuara,

- Raportin mjekësor të datës 21.10.2019 të Qendrës Emergjente – Spitalit “Sheikh Zayed”, në Vushtrri është përshkruar se si pacientja është sjellë ne Qendrën Emergjente për shkak të dhunës fizike, dhe pas caktimit të diagnozës së të dëmtuarës e njëjta është udhëzuar ta konsultojë mjekun ligjor për caktuar shkallën e lëndimit,.

- Akt Ekspertimin Mjeko Ligjor të datës 14.12.2019 të përgatitur nga mjeku ligjor Dr. Musa Gashi, në të cilin është konstatuar natyra e lëndimeve të të dëmtuarës M. Rr.i dhe atë, dëmtime të lehta trupore

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurës, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par 1.4 të KPRK-s, pasi që i pandehura fillimisht e kishte kapur të dëmtuarën për dore dhe më pas e kishte goditur me shqelm duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin..

Për gjykatën deklarata e të pandehurës në fjalën hyrëse dhe fjalën përfundimtare dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë çështje penale edhe pse pjesërisht i fali besimin, në disa pika ishte, kontestuese, jo e plotë, jo bindëse, jo konsistencë dhe kishte për qëllim shmangien nga përgjegjësia penale dhe të njëjtës gjykata nuk ja fali besimin e plotë.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se vepra e parë penale është e sanksionuar me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vite burgim, kjo gjykatë si rrethanë rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, prezencën e dhunës me rastin e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë lehtësues se e pandehura më parë nuk ka kryer veprë penale, nuk e ka përsëritur veprën penale, është e gjendjes së dobët ekonomike, si dhe faktin se e njëjta përkujdeset për dy fëmijët e saj jashtë - martesor.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që i pandehuri në të ardhmen të ketë kujdes të shtuar, që të mos bie në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Arsyet lidhur me shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPPK-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par 2 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.02/2020, datë: 27.07.2020

Procesmbajtësja

Bahrije Smakolli

GJYQTARI

Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.